

# GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

**Pml.Kzz 1/2014**

**(P. Nr. 45/2010 Gjykata e Qarkut në Mitrovicë)**

**(PAKR 966/2012 Gjykata e Apelit)**

Data:

**7 maj 2014**

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti (kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues), Gjyqtari të EULEX-it Willem Brouwer dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Valdete Daka si anëtarë të kolegjit, dhe Zyrtarja ligjore e EULEX-it Kerry Kirsten Moyes si procesmbajtëse, në lëndën penale me numër P. Nr. 45/2010, të (atëherë) Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, kundër:

**S. G.**, me nofkën "X", i biri i X dhe X, i lindur më X në fshatin X, komuna e X, shqiptar i Kosovës, aktualisht me vendbanim në rr. X në X, i martuar dhe ka katër fëmijë, më parë i shpallur fajtor për Detyrim në tentativë, rrezikim i sigurisë dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, në paraburgim prej 6 majit 2010. S. G. është akuzuar për gjashtë pika të **Krimeve të luftës kundër popullatës civile** në shkelje të nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), gjithashtu të parapara me nenet 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe në shkelje të nenit të përbashkët 3 të Konventës së Gjenevës (KGj) dhe neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit shtesë II të Konventës së Gjenevës (PSh II). Ai është shpallur fajtor për katër pika të **Krimeve të luftës** nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë. Ky aktgjykim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit në 1 pikë të **Krimeve të luftës**. Ai gjithashtu është shpallur fajtor për **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në shkelje të nenit 328(2) të KPK-së;

**R. A.**, me nofkën "X", i biri i X dhe X, i lindur më X në fshatin X, komuna e X, shqiptar i Kosovës, aktualisht me vendbanim në fshatin X, X, i martuar dhe ka katër fëmijë, i padënuar më parë, në paraburgim prej 23 qershorit 2010. R. A. është akuzuar për tri pika të **Krimeve të luftës kundër popullatës civile** në shkelje të neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, gjithashtu të parapara me nenet 23 dhe 120 të KPK-së, dhe në shkelje të nenit të përbashkët 3 të KGj-së dhe neneve 4 dhe 5(1) të PSh-së II. Ai është shpallur fajtor për 2 pika të **Krimeve të luftës** nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë. Ky aktgjykim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit në 1 pikë të **Krimeve të luftës**;

**S. R.**, i biri i X dhe X, i lindur më X në fshatin X, komuna e X, aktualisht me vendbanim në X, i martuar dhe ka katër fëmijë, i padënuar më parë. S. R. është akuzuar për tri pika të veprës penale **Krimeve të luftës kundër popullatës civile** në shkelje të neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, gjithashtu të parapara me nenet 23 dhe

120 të KPK-së, dhe në shkelje të nenit të përbashkët 3 të KGj-së dhe neneve 4 dhe 5(1) të PSh-së II; Ai është shpallur fajtor nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë për një pikë të **Krimeve të luftës**.

*et al*

*duke vepruar në lidhje me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokati mbrojtës M. H. më 17 janar 2014 në emër të pandehurit S. G., të paraqitur nga avokati mbrojtës G. K. më 24 dhjetor 2013 në emër të pandehurit R. A., dhe nga avokati mbrojtës Q. Q. më 14 janar 2014 në emër të pandehurit S. R. kundër aktgjykimeve të (atëherë) Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në këtë lëndë të datës 29 korrik 2011 (për S. G. dhe R. A.) dhe 13 tetor 2011 (për S. R.), dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 11 shtator 2013;*

*pas shqyrtimit të përgjigjeve ndaj kërkesave të paraqitura nga Prokurori i Shtetit KMLP. II. – ZZZK. II. Nr. 1/14 të paraqitur më 15 janar 2014 për R. A., dhe më 14 shkurt 2014 për S. G. dhe S. R.n;*

*pas këshillimit dhe votimit më 7 maj 2014;*

*sipas nenit 418 dhe neneve 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së)*

*lëshon këtë*

---

## AKTGJYKIM

---

- 1. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës G. K. në emër të pandehurit R. A., nga avokati mbrojtës Q. Q. në emër të pandehurit S. R., kundër aktgjykimeve të (atëherë) Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 29 korrik 2011 (për R. A.) dhe 13 tetor 2011 (për S. R.), dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 11 shtator 2013, refuzohet si të pabazuara. Aktgjykimet e lartpërmendura nuk ndryshohen në bazë të këtyre kërkesave.**
- 2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës M. H. në emër të pandehurit S. G. kundër aktgjykimit të (atëherë) Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 29 korrik 2011 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 11 shtator 2013, pranohet pjesërisht. Aktgjykimi i (atëherë) Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 29 korrik 2011 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 11 shtator 2013, ndryshohen për pjesën e S. G., si në vijim:**

- **Akuza për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve (Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, pika 7), kundër të pandehurit S. G., në shkelje të nenit 328(2) të KPK-së, refuzohet sipas nenit 363 (1.1.3) të KPP-së dhe Ligjit nr. 04/L-209 për Amnisti (Ligji për amnisti).**
- **I pandehuri S. G. lirohet nga dënimi me gjobë. Dënimi unik me burgim prej (15 viteve) mbetet. Arma mbetet e konfiskuar.**

**Pjesa e mbetur e kërkesës refuzohet si e pabazuar.**

## ARSYETIM

### 1. Historia e procedurës

#### A. Aktakuza

1.1. Më 6 gusht 2010, Prokurori i PSRK-së ka ngritur aktakuzën PPS Nr. 08/2009 kundër të pandehurve S. G. dhe R. A., duke i akuzuar për veprat penale Krime të luftës kundër popullsisë civile sipas neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, aktualisht të dënueshme me nenet 23 dhe 120 (2) të KPK-së. Veprat e pretenduara penale kanë ndodhur në dy kampe të udhëhequra nga UÇK-ja në X dhe X në Republikën e X më 1999. S. G. gjithashtu është akuzuar edhe për posedim të paautorizuar të armës. Aktakuza është konfirmuar me aktvendimin KA Nr. 64/2010, më 24 nëntor 2010.

1.2. Më 29 dhjetor 2010, Prokurori i PSRK-së ka ngritur aktakuzën PPS Nr. 117/2010 kundër S. R. dhe një të bashkë-akuzuari, H. H., duke i akuzuar ata për Krime të luftës kundër popullsisë civile. Veprat e pretenduara penale kanë ndodhur në dy kampe të udhëhequra nga UÇK-ja në X në Republikën e X më 1999.

1.3. Më 16 shkurt 2011, Prokurori ka lëshuar aktvendimin mbi zgjerimin e hetimeve penale të lëndës PPS Nr. 117/2010 për të përfshirë të bashkë-akuzuarin e pestë Sh. H., si të dyshuar. Rrjedhimisht, më 25 shkurt 2011, Prokurori ka ngritur një aktakuzë të ndarë PPS Nr. 117/2010 (të regjistruan nga gjykata si KA Nr. 09/2011) kundër Sh. H. duke e akuzuar atë për dy pika të Krimeve të luftës në lidhje me të paraburgosurit në kampin e UÇK-së në X.

1.4. Me kërkesë të Prokurorit të PSRK-së, më 2 mars 2011 gjyqtari për konfirmim ka lëshuar urdhrin për bashkim të lëndës penale KA Nr. 09/2011 kundër Sh. H. me lëndën penale KA Nr. 208/2010 kundër H. H. dhe S. R., pasi që veprat penale të pretenduara kanë qenë të ndërlidhura dhe mbështeteshin në prova të përbashkëta. Më 25 mars 2011, gjyqtari për konfirmim ka lëshuar aktvendimin KA Nr. 208/2010 duke konfirmuar të dy

aktakuzat dhe duke i shpallur të gjitha provat në shkresat e lëndës si të pranueshme.

## B. Gjykimi

1.5. Gjykimi kundër S. G. dhe R. A. është hapur më 14 mars 2011 para një trupi gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtari kosovar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Më 14 prill 2011, Prokurori ka propozuar që lënda kundër H. H., S. R. dhe Sh. H. të bashkohet me gjykimin në vazhdim e sipër kundër S. G. dhe R. A.. Më 4 maj 2011, gjykimi kundër H. H., S. R. dhe Sh. H. në lëndën P Nr. 13/2011 është hapur, gjithashtu në prani të pandehurve S. G. dhe R. A. dhe avokatëve të tyre mbrojtës. Të gjitha palët janë pajtuar me bashkimin e lëndëve dhe kështu gjykimi ka vazhduar për të gjithë të pesë akuzuarit.

1.6. Më 16 qershor 2011, avokati mbrojtës Q. Q. ka aplikuar për leje nga gjykata që i pandehuri S. R. të udhëtoj urgjentisht në X për një operacion të nevojshëm të zemrës. Më 20 qershor 2011, trupi gjykues ka ndarë lëndën kundër S. R. sipas nenit 34 të KPPK-së, dhe gjykimi ka vazhduar kundër katër të pandehurve të tjerë.

1.7. Fjalët përfundimtare janë dëgjuar më 21 dhe 25 korrik 2011, dhe aktgjykimi në lidhje me të pandehurit S. G., R. A., H. H. dhe Sh. H. është shpallur më 29 korrik 2011.

1.8. Më 12 tetor 2011, gjykimi në lëndën e ndarë kundër S. R. ka vazhduar dhe më 13 tetor 2011 është shpallur aktgjykimi.

## C. Aktgjykimet

1.9. I pandehuri S. G. është shpallur fajtor për 4 pika të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile sipas neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së dhe në lidhje me nenin e përbashkët 3 të KGj-së dhe neneve 4 dhe 5(1) PSh II (trajtimit çnjerëzor i të burgosurve civil, torturë e të burgosurve civil, cenim i integritetit trupor të të burgosurve civil përmes keqtrajtimit dhe rrahjeve). Ai gjithashtu është shpallur fajtor për posedim të paautorizuar të armëve (pika 7) sipas nenit 328 (2) të KPK-së. Ai është dënuar me 8, 12,9 dhe 8 vite burgim respektivisht për secilën pikë të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile. Për veprën Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve ai është dënuar me gjobë prej 4,000.00 Euro. Dënimi unik është caktuar me 15 vite burgim dhe me gjobë prej 4,000.00 Euro. Koha e kaluar në paraburgim është llogaritur. Ai është liruar nga dy pika të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile (vrasje, dhënie e urdhrave për cenim të integritetit trupor të të burgosurve civil).

1.10. I pandehuri R. A. është shpallur fajtor për dy pika të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile sipas neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së në lidhje me nenin e përbashkët 3 të KGj-së dhe nenet 4 dhe 5(1) të PSh II (cenim i integritetit trupor të të paraburgosurve civil). Ai është dënuar me 8 dhe 9 vite burgim respektivisht për secilën pikë të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile. Dënimi unik është caktuar me 12 vite burgim, dhe koha e kaluar në paraburgim është llogaritur. Ai është liruar nga një pikë e

Krimeve të luftës kundër popullsisë civile (trajtim çnjerëzor i të paraburgosurve civil).

1.11. I pandehuri S. R. është shpallur fajtor për një pikë të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile sipas neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së në lidhje me nenin e përbashkët 3 të KGj-së dhe nenet 4 dhe 5(1) të PSh II (torturë e një civili të paraburgosur). Ai është liruar nga dy pika të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile. Ai është dënuar me 5 vite burgim.

1.12. Për të qenë sa më të plotë, në lidhje me dy të bashkë-akuzuarit të cilët nuk kanë paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme vëren si në vijim. I pandehuri H. H. është shpallur fajtor për një pikë të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile (torturë e një të paraburgosuri civil), është liruar nga një pikë e Krimeve të luftës kundër popullsisë civile, dhe është dënuar me 6 vite burgim. I pandehuri Sh. H. është shpallur fajtor për një pikë të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile (torturë e një të paraburgosuri civil), është liruar nga një pikë e Krimeve të luftës kundër popullsisë civile, dhe është dënuar me 7 vite burgim.

#### D. Procedura e ankesave

1.13. Avokatët mbrojtës M. H. dhe H. M. kanë paraqitur ankesë të përbashkët në emër të S. G. më 14 shkurt 2012. Avokati mbrojtës G. K. ka paraqitur ankesë në emër të R. A. më 15 shkurt 2012. Avokati mbrojtës Q. Q. ka paraqitur ankesë në emër të S. R. më 4 prill 2012. (Ankesa gjithashtu janë paraqitur edhe në emër të H. H. dhe Sh. H.). Të gjitha ankesat janë dorëzuar me kohë. Më 25 janar 2013, Prokurorja e Apelit e EULEX-it Judit Eva Tatrai ka paraqitur mendimin dhe propozimin në përgjigje të ankesave.

1.14. Më 13 janar 2013, lënda është transferuar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë në Gjykatën e Apelit sipas nenit 39 (1) të Ligjit mbi gjykatat, Ligji nr. 03/L-199. Seanca e Gjykatës së Apelit është mbajtur më 10 shtator 2013, kur kolegji ka bashkuar procedurat penale në lëndën e ndarë kundër të pandehurit S. R. me lëndën kundër katër të pandehurve të tjerë.

1.15. Gjykata e Apelit nuk është pajtuar me argumentet se Gjykata e Qarkut kishte bërë shkelje substanciale të normave të ligjit të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe se rezultati i ligjit material ishte zbatuar gabimisht në dëm të pandehurve. Së pari, Gjykata e Apelit nuk ka gjetur asnjë kundërtënie apo mospërputhje brenda dispozitivit. Së dyti, Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se dispozitivi nuk është në përputhje me arsyetimin e aktgjykimit. Së treti, Gjykata e Apelit ka gjetur se nuk ka kundërtënie me provat dhe përfundimet e bëra nga Gjykata e Qarkut, siç është pretenduar.

1.16. Sidoqoftë, Gjykata e Apelit ka ri-cilësuar aktet e S. G. dhe R. A.. Ankesat e tyre kanë ngritur çështjen e cilësimit për kryerjen e përsëritur të veprës së njëjtë penale. Gjykata e Qarkut kishte shpallur fajtorë të dy të pandehurit për disa pika të Krimeve të

luftës kundër popullsisë civile dhe ka shqiptuar atyre dënime të ndara për secilën pikë individuale, edhe pse të gjitha aktet e tyre përkatëse kanë qenë në kundërshtim të një neni të ligjit material – nenit 142 të KPRSFJ-së. Gjykata e Apelit ka marrë parasysh çështjen nëse kryerja e përsëritur e veprës penale Krime të luftës kundër popullsisë civile siç është paraparë me nenin 142 të KPRSFJ-së do të duhet të cilësohet si pika të ndara të cilat rezultojnë në dënime të ndara, p.sh. një dënim për secilën pikë individuale, apo do të duhet të caktohet vetëm një dënim për të gjitha aktet e tilla së bashku. Gjykata e Apelit ka marrë parasysh nenin 48(1) të KPRSFJ-së dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme (e cila ka vepruar si gjykatë e shkallës së dytë) në lëndën penale kundër L. G.<sup>1</sup>. Ka konstatuar se është më e përshtatshme që të zbatohet vetëm parimi i përputhjes ideale. Kjo qasje është pranuar gjerë në literaturën juridike dhe në traditën civile të praktikës së gjykatës në tërë Evropën kontinentale. Prandaj, aktet e të pandehurit S. G., janë ri-cilësuar për të përbërë një vepër penale të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile në shkelje të nenit 142 të KPRSFJ-së, gjithashtu të parapara me nenet 120 dhe 121 të KPK-së, dhe në shkelje të nenit të përbashkët 3 të KGj-së dhe neneve 4 dhe 5(1) të PSh II, me zhvillime në mbështetje të dënimeve të detajuara në 4 nën-paragrafët. Ngjashëm, Gjykata e Apelit gjithashtu ka ri-cilësuar aktet e R. A. për të përbërë një vepër penale të Krimeve të luftës kundër popullsisë civile në shkelje të nenit 142 të KPRSFJ-së, gjithashtu të parapara me nenet 120 dhe 121 të KPK-së, dhe në shkelje të nenit të përbashkët 3 të KGj-së dhe neneve 4 dhe 5(1) të PSh II, me zhvillime në mbështetje të dënimeve të detajuara në 2 nën-paragrafë.

1.17. Prandaj, ankesat e avokatëve mbrojtës për S. G. dhe R. A., janë pranuar pjesërisht për të ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 29 korrik 2011 Nr. 45/2010 për ri-cilësimin e akteve të S. G. dhe R. A.. S. G. është dënuar me 15 vite burgim dhe R. A. me 12 vite burgim (dënimet e njëjta siç ishin shqiptuar nga Gjykata e Qarkut). Për shkak se ankesat e avokatëve mbrojtës për H. H. dhe Sh. H. ishin refuzuar, pjesa e mbetur e aktgjyimit (29 korrik 2012) është vërtetuar.

1.18. Ankesa e avokatit mbrojtës për S. R. është refuzuar si e pabazuar. Prandaj, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë i datës 13 tetor 2011 Nr. 45/2010, është vërtetuar.

## **2. Parashtrësit e palëve**

### **A. Avokati mbrojtës M. H. për S. G..**

2.1. Kërkesa thekson se është bazuar në dy arsye; shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

---

<sup>1</sup> Ap.-Kž. Nr. 89/2010, data 26 janar 2011

*a. Shkeljet substanciale të dispozitave të kodit të procedurës penale (neni 384, paragrafi 1, pika 12 në lidhje me nenin 370të KPPK-së).*

- Aktgjykimi i shkallës së parë i hedh poshtë si ‘mospërputhje të vogla’ kundërthëniet e konsiderueshme të fakteve vendimtare. Dëshmitari ‘B’ ka thënë gjatë fazës së hetimeve se G. ishte i motivuar nga hakmarrja nga konflikti në mes tyre në burgun e Dubravës, dhe më vonë e ka mohuar këtë. Ka pasur edhe kundërthënie të tjera në mes të dëshmitarëve të dhëna gjatë hetimeve dhe atyre të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor.
- Gjithashtu ka pasur kundërthënie të konsiderueshme në deklaratat e dëshmitarit ‘H’ të dhëna gjatë hetimeve dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor.
- Dëshmitari ‘A’ ka deklaruar në gjykim se G. nuk ka përdorë dhunë e as nuk ka pasur pozitë komanduese në X.
- Provat I. I. nuk janë në përputhje me provat tjera të dëshmitarit ‘K’, i pari duke thënë se është goditur dy herë me shuplakë nga G. dhe pastaj ishte goditur me patericën e tij, kurse ky i fundit ka deklaruar se ai ka qenë dëshmitarë i ngjarjes vetëm një herë kur S. e ka shtyrë atë me patericat e tij.
- Aktgjykimi i shkallës së parë ka neglizhuar deklaratat e pesë dëshmitarëve të mbrojtjes.
  
- Aktgjykimi i shkallës së dytë nuk i përmbush kushtet e nenit 389 pasi që nuk jep arsytim në lidhje me gjetjet e aktgjykimit të shkallës së parë, vetëm përmend përsëri paragrafët në lidhje me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës dhe përsërit të njëjtin arsyetim.
  
- E Drejta Humanitare Ndërkombëtare nuk është e zbatueshme. Shtrirja e nenit të përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës ‘në çdo kohë dhe në çdo vend’ nuk do të thotë territori jashtë territorit të njëres nga palët në konflikt. ‘Territori’ nuk do të thotë kufijtë shtetëror politik apo kombëtar. Kjo shkel doktrinën e sovranitetit të shtetit. X nuk ka qenë palë në konflikt e as anëtare e NATO-s. Zbatimi i Konventave pushon me ndërprerjen e operacioneve ushtarake, dhe prandaj tani nuk zbatohet. Përfundimisht, çfarëdo dyshimi në lidhje me faktet apo zbatueshmërinë e ligjit penal duhet të interpretohet në dobi të të pandehurit.

*b. Shkeljet e ligjit penal*

- Ka pasur zbatim të kundërligjshëm të Konventave të Gjenevës.
- Deklaratat e dëshmitarëve ishin kundërthënëse në mes vete dhe me dëshmitë tjera.
- Dëshmia e I. I. nuk është vërtetuar.
- Nuk është dhënë asnjë arsye për gjetjen si të provuar se i pandehuri ka qenë përgjegjës për mënyrën ‘trajtim çnjerëzor’ në X, dhe vetëm dëshmitari B ka dhënë prova për pozitën komanduese të G.
- Dënimi është tepër i ashpër për një veprë të vetme, dhe është bërë pa i marrë parasysh rrethanat e tij të përgjithshme (ai është në gjendje të rëndë shëndetësore, ka 4 fëmijë, është sjellë shumë mirë gjatë gjithë gjykimit). Për më tepër, një dënim më i butë gjithashtu do të arrinte qëllimin e sanksioneve penale sipas nenit 41 të KPPK-së pasi që

nuk do të ndodhin rrethana të ngjashme në të ardhmen tani kur Kosova është në paqe.

2.2. Avokati mbrojtës kërkon që i pandehuri S. G. të lirohet nga akuzat, apo që të dy aktgjykimet i Gjykatës së Qarkut i datës 29 korrik 2011 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të 'prishen dhe lënda të kthehen në Gjykatën e Qarkut për rigjykim, apo që t'i shqiptohet dënimi më i butë i mundshëm. Më tutje, avokati mbrojtës bën thirrje që të lirohet nga vepra penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve (pika 7) për shkak të amnistisë së ofruar me Ligjin për amnisti.

#### B. Avokati mbrojtës G. K. për R. A.

2.3. Kërkesa thekson se është bazuar në tri arsye; shkelje të ligjit penal, shkelje esenciale të kodit të procedurës penale, shkeljet tjera të dispozitave të procedurës penale.

- në lidhje me dënimin për dy veprat penale, vetëm një vepër penale është kryer.
- të dy aktgjykimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë janë bazuar në prova të papranueshme.
- Nuk ka asnjë provë se A. ka keqtrajtuar dëshmitarin 'O' dhe ai nuk është dëgjuar gjatë gjyqimit, që do të thotë se deklarata e tij nuk duhet të merret parasysh.
- të dy aktgjykimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë nuk kanë përshkruar faktet në mënyrë të qartë dhe të plotë dhe pse i kanë konsideruar të vërteta.
- Shkelja e nenit 11, paragrafit 1 dhe neneve 14 dhe 15 të 'KPP-së'. Po të vlerësoheshin provat drejtë A. nuk do të shpallej fajtor.
- të dyja nuk kanë vlerësuar saktë provat kundërtënëse. Më saktësisht, lidhur me I. I., dispozitivi ka thënë se ai është 'rrahur rëndë dhe vazhdimisht' dhe në pikën 3 thuhet 'në numër të papërcaktuar të rasteve ...në mes të 12 prillit dhe mesit të qershorit 1999'. Pika 249 e aktgjyqimit thotë 'dy raste të ndryshme. Pika 165 thotë pas dy rrahjeve të rënda kanë pasuar rrahjet më të lehta nga ushtarët e tjerë të UÇK-së. – Ka prova të pamjaftueshme se cilado rrahje e I. I. është bërë me urdhër të A..
- Në lidhje me dëshmitarët 'K' dhe 'M' ata vetë kanë deklaruar se janë qëlluar 'vetëm' një herë nga A., në të njëjtën ditë që kanë arritur në X.
- Nuk ka asnjë provë se A. ka rrahur dëshmitarin 'N'. Ai vetë ka përmendur vetëm ushtarët e tjerë të UÇK-së.

2.4. Avokati mbrojtës propozon që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut i datës 29 korrik 2011 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të anulohen dhe lënda të kthehet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë për rigjykim, apo të ndryshohet dënimi në një dënim më të butë.

#### C. Avokati mbrojtës Q. Q. në emër të S. R.

2.5. Kërkesa bazohet në dy arsye; shkelje substanciale të nenit 403, paragrafëve 1 dhe 12 të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

- dispozitivi i aktgjyqimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe kundërtënë me



arsyetimin e tij.

- aktgjykimi i apeluar nuk i është përgjigjur ankesave apo individualizuar rolin e R.
- për ta shpallur një person fajtor, dashja e të akuzuarit patjetër duhet të jetë e bazuar në prova dhe fakte të pakontestueshme.
- të gjitha veprimet inkriminuese mbështeten ekskluzivisht në dëshmitarin 'N' i cili së bashku me dëshmitarët 'K', 'L' dhe 'M' të gjithë deklarojnë se R. ka qenë njëri nga më të mirën në kamp.
- ai nuk mund të jetë fajtor për veprim në bashkëkryerje sipas nenit 22 (të KPRSFJ-së) dhe gjithashtu përgjegjës sipas nenit 26 të 'LAP' sepse përgjegjësia sipas nenit 26 e absorbon përgjegjësinë nën nenin 22.
- për të vërtetuar bashkëkryerjen sipas nenit 22 duhet të ketë një plan verbal apo me shkrim për veprën penale.
- Neni i përbashkët 3 i Konventës së Gjenevës të vitit 1949 nuk është i zbatueshëm në këtë lëndë. Konventa thekson se kur njëra nga palët në konflikt ka arsye të bazuara që të vlerësojë se një person është përfshirë në aktivitete të dëmshme, ai person nuk i gëzon të drejtat dhe privilegjet e Konventës. Gjithashtu, ka pasur arsye të bazuara se këta persona kanë qenë, dhe do të ishin, duke kryer aktivitete të dëmshme kundër UÇK-së, dhe të gjithë kanë të drejtë në vetëmbrojtje.
- çdo dyshim në lidhje me faktet duhet të interpretohet në dobi të pandehurit.
- dashja e tij nuk është analizuar në mënyrë të qartë.

2.6. Avokati mbrojtës propozon që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut i datës 13 tetor 2011 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të anulohen dhe lënda të kthehet në Gjykatën Themelore për rigjykim.

#### D. Prokurori

2.7. Në përgjigjen e tij Prokurori i shtetit propozon që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohen dhe të dy aktgjykimet e gjykatës së Qarkut dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të vërtetohen, përveç sa i përket propozimit të avokatit mbrojtës për S. G. në lidhje me Mbajtjen në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, të cilën Gjykata Supreme duhet të marrë parasysh të zbatojë Ligjin për amnisti (04/L-209) sipas praktikës ligjore aktuale (arma mbetet e konfiskuar). Prokurori i shtetit thekson se të gjitha kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë pa merita, dhe të gjitha argumentet janë paraqitur paraprakisht, janë marrë parasysh dhe gjykuar nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata e Apelit. Sipas nenit 432 paragrafit 2 të KPP-së çështjet në lidhje me vlerësimin e provave nuk mund të jenë bazë për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjendja mjekësore e S. G. tashmë është marrë parasysh nga Gjykata e Apelit.

### **3. Gjetjet e kolegjit**

#### A. Gjetjet e përgjithshme

3.1. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nga avokatët mbrojtës dhe përgjigja e Prokurorit të shtetit janë të pranueshme dhe të paraqitura me kohë.

3.2. Gjykata Supreme vëren se të gjithë avokatët mbrojtës ngritin çështjen e vlerësimit të provave nga Gjykata e Qarkut. Ia përkujtomë avokatëve mbrojtës se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet mbi bazën e shkeljes së ligjit penal, shkeljes së caktuar substanciale të dispozitave të procedurës penale, apo nëse ekziston ndonjë shkelje tjetër e procedurës penale e cila që ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Kërkesa nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 432 i KPP-së). Gjykata Supreme pajtohet me Prokurorin e shtetit se përmbajtja e kërkesave është kryesisht përsëritje e ankesave të tyre kundër aktgjyqimit të shkallës së parë, të cilat janë përgjigjur në tërësi nga Gjykata e Apelit. Është një tendencë e përhapur gjerë në mesin e shumë avokatëve mbrojtës që të mundohet të përdorin kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si ankesë të dytë, e cila nuk do të duhej të ndodhte.

3.3. Në përgjithësi, të gjithë avokatët mbrojtës pohojnë se të dy aktgjyqimet nuk kanë treguar qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye janë konsideruar të vërteta, apo se janë të pakuptueshme ose kundërthënëse. Gjykata Supreme nuk pajtohet aspak me këto parashtrësia. Aktgjyqimi i shkallës së parë është i hollësishëm dhe i qartë se çfarë saktësisht është gjetur e provuar – përsëri, kjo është detajuar në mënyrë plotësisht të kuptueshme në paragrafët 54 deri 214. Aktgjyqimi i Gjykatës së Apelit është njësoj i artikuluar në arsyetimin e tij dhe plotësisht i qartë sa i përket gjetjeve të tij. As Gjykata Supreme nuk mund të identifikoj asnjë kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit në asnjërin aktgjykim. Prandaj, kolegji duke iu referuar arsyetimit të gjendjes faktike në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe pa asnjë arsye të mëtejme për të analizuar në mënyrë më të detajuar, nuk gjen asnjë shkelej të rregullave të nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së / nenit 384 paragrafit 1 pikës 12 të KPP-së siç është pretenduar në kërkesa.

#### B. Neni i përbashkët 3 i KGJ-së

3.4. Avokatët mbrojtës për S. G. dhe S. R. pretendojnë se neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës nuk zbatohen në këtë lëndë për arsye të ndryshme: a) Konventa nuk mund të zbatohet për aktet të cilat kanë ndodhur në territorin e një shteti i cili nuk ka qenë palë në konflikt, dhe Shqipëria nuk ka qenë palë në konflikt e as anëtare e NATO-s, b) zbatimi i Konventës pushon me përfundimin e operacioneve ushtarake, dhe prandaj tani nuk vlen, c) personi i përfshirë në aktivitete të dëmshme nuk i gëzon të drejtat dhe privilegjet e Konventës.

3.5. Së pari, Gjykata Supreme vëren se çështja nuk ka të bëjë me juridiksionin dhe kompetencat e Gjykatave të Kosovës për të gjykuar krimet e akuzuara kundër të pandehurve. Në këtë kuptim, Gjykata Supreme vetëm i referohet asaj që Gjykata e Qarkut dhe Gjykata e Apelit kanë arsyetuar në lidhje me këto çështje.

3.6. Gjykata Supreme thekson se çështja e ngritur në kërkesa ka të bëjë me elementet e veprës penale Krime të luftës kundër popullsisë civile: a janë përmbushur elementet e kësaj vepre penale për shkak të faktit se aktet e pretenduara penale kanë ndodhur në Shqipëri, e cila nuk ka qenë palë në konflikt. Mbrojtja i referohet nenit të përbashkët 3 të KGj-së i cili thotë: *'Në rast të konfliktit të armatosur jo të karakterit ndërkombëtar i cili ndodh në territorin e njëres nga palët e larta kontraktuese ....'*

Gjykata Supreme vëren se aktakuza është bazuar në nenin 142 të KPRSFJ-së i cili thekson: *'Kushdo që në shkëlqje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit, urdhëron .... ose kryen njërin nga aktet paraprake ...'* Në aktakuzë Prokurori ka specifikuar, se në këtë lëndë rregullat e shkalura të së drejtës ndërkombëtare janë rregullat e nenit të përbashkët 3 të KGj-së dhe neneve 4 dhe 5(1) PSh II. Kjo do të thotë se pyetja për tu përgjigjur është: a cakton neni i përbashkët parakusht për vendin e krimit; a duhet aktet penale të ndodhin në territorin e palës në konflikt?

3.7. Gjykata e Qarkut ka sqaruar në paragrafin 42.3 se çfarë mendon gjykata se është e nevojshme për zbatimin nenit të përbashkët 3 të KGj-së. Një kusht që e detajojnë është se sjellja e pretenduar ka ndodhur në territorin nën kontroll të njëres palë në konflikt. Gjykata përmend arsyet për gjetjet e tyre se sjellja e pretenduar ka ndodhur në territorin nën kontrollin e UÇK-së, e cila ka qenë palë në konflikt. Më vonë në paragrafin 43 gjykata përfundon se gjykata ka juridiksion përkundër faktit se aktiviteti kriminal i pretenduar ka ndodhur në Shqipëri, dhe nëse dëshmohen veprat mund të cilësohen si krim të luftës përkundër faktit se krimet kanë ndodhur në territorin e palës së tretë (Shqipërisë).

3.8. Gjykata Supreme nuk pajtohet me supozimin e Gjykatës së Qarkut (dhe Gjykatës së Apelit) se neni i përbashkët 3 i KGj-së përfshin kushtin se sjellja e pretenduar duhet patjetër të ketë ndodhur në territorin nën kontroll të njëres nga palët në konflikt. Ajo që neni 3 thotë është se kur të ndodh konflikti (dhe jo kur të ndodhin veprat) në territorin e palës së lartë kontraktuese të Konventave të Gjenevës, atëherë *palët në konflikt* janë të obliguara me Konventë. Është vërejtur se X është bërë palë e lartë kontraktuese e Konventave të Gjenevës më 15 dhjetor 1950 dhe Protokolleve Shtesë më 28 dhjetor 1978. Gjithashtu është vërejtur se neni 1 i Protokollit Shtesë II është formuluar ngjashëm (...konfliktet të cilat ndodhin në territorin e palës së lartë kontraktuese).

3.9. Pas përcaktimit të mbrojtjes së garantuar për personat të cilët nuk kanë pasur rol aktiv në veprime ushtarake, paragrafi i parë i nenit të përbashkët 3 të KGj-së përcakton si në vijim: *'Për këtë qëllim, aktet në vijim janë dhe do të mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend në lidhje me personat e lartpërmendur ...'*

Gjykata Supreme fillimisht thekson se në formulimin e nenit të përbashkët 3 të KGj-së nuk ekziston asnjë kusht që veprat penale të ndodhin në zonën territoriale të konfliktit në zhvillim e sipër ose në zonën nën kontrollin e njëres palë në konflikt. Së dyti, formulimi i

cituar në nenin e përbashkët 3 të KGJ-së qartë pohon se aktet janë të *ndaluara 'në çdo vend dhe në çdo kohë'*. Së treti, i tërë qëllimi i KGJ-së përkrah një interpretim të gjerë në çështjen e zbatimit të tij. Prandaj, përfundimi është se obligimet e palëve në konflikt nuk kufizohen në zonë territoriale specifike, por vlejné për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me konfliktin, kudo që ndodhin. Tani është me rëndësi lidhja në mes akteve të pretenduara të të akuzuarve dhe konfliktit të armatosur. Nëse lidhja nuk dëshmohet, atëherë nuk janë plotësuar elementet e krimeve të luftës kundër popullsisë civile (Neni 142 KPRSFJ).

Gjykata e Qarkut i ka dhënë arsyet për vërtetimin e ekzistimit të lidhjes (shih paragrafin 42.3 dhe 45). Gjykata Supreme vëren se argumentet e paraqitura (kryerësit duke qenë pjesëtarë të UÇK-së, supozimi se viktimat kishin simpati për palën kundërshtare ose se pala kundërshtare kishte bashkëpunuar me ta, veprat e pretenduara ishin kryer për shkak të kësaj simpatie të supozuara, ekzistimi dhe qëllimi i kampeve të UÇK-së në X dhe në X) janë relevante dhe në këto fakte mund të mbështetet ekzistimi i lidhjes. Nuk ka asnjë dyshim se veprat kanë ndodhur në lidhje me konfliktin e armatosur.

Siç ka pohuar Gjykata e Qarkut, viktimat nuk kishin rol aktiv në veprimet ushtarake. Nuk mund të pranohet që mjetet mbrojtëse të Konventave të Gjenevës kundër trajtimit çnjerëzor dhe cenimit të integritetit trupor me anë të rrahjes nuk vlejné për civilët të dyshuar të jenë simpatizues të armikut.

3.10. Prandaj, Gjykata Supreme i refuzon të gjitha argumentet se veprat penale nuk përfshihen në nenin e përbashkët 3 të KGJ-së dhe në nenet 4 dhe 5(1) PSH II. Nuk ka shkelje të Ligjit Penal siç pretendohet në kërkesa.

### C. Sabit Geci

3.11. Avokati mbrojtës për S. G.in pohon se zbatimi i Konventave pushon me përfundimin e operacioneve ushtarake. Siç është vërtetuar nga Gjykata e Qarkut, veprat penale ishin kryer gjatë konfliktit të armatosur, dhe Konventa ishte në fuqi në atë kohë. Kolegji konsideron se ky argument rrjedh nga moskuptimi i ligjit nga avokati mbrojtës, i cili është i qartë në këtë pikë.

3.12. Avokati mbrojtës po ashtu pohon se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ka shpërfillur ekzaminimin e deklaratave të dëshmitarëve të mbrojtjes O. K., S. D., H. A., Xh. H. dhe R. Q.. Kolegji nuk pajtohet. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut duke filluar nga paragrafi 54 me titull 'Vlerësimi i provave: Gjetjet faktike' pohon se faktet që janë paraqitur të detajuara në këtë pjesë i konsideron si të vërtetuara. Kolegji vëren se O. K. përmendet në mënyrë specifike, dhe dëshmitarët e tjerë të mbrojtjes nuk ishin të pranishëm në vendim

dhe në kohën e kryerjes së veprave penale, dhe se qëllimi i dëshmisë së tyre duket se ishte përkrahja e pohimit të S. G. se në mes tij dhe dëshmitarit B kishte një inat. Gjykata Supreme prapë i referohet vlerësimit të hollësishëm të provave në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në mes të paragrafëve 54 dhe 214. Kolegji nuk gjen asnjë shkelje, siç është pretenduar.

3.13. Sa i përket dënimit të S. G. në lidhje me veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në përputhje me nenin 328 (2) të KPP-së, kolegji vëren efektin e Ligjit Nr. 04/L-209 për Amnistinë (Ligji për amnisti) për këtë vepër. Ligji ka hyrë në fuqi më 4 tetor 2013. Në përputhje me nenin 2 (1) të Ligjit për amnisti të gjithë kryerësit e veprave penale të renditura në nenin 3 të këtij ligji, që janë kryer para 20 qershorit 2013 do të lirohen tërësisht nga ndjekja penale ose nga ekzekutimi i dënimit për ato vepra penale, në përputhje me kushtet e nenit 3 të këtij ligji. Në përputhje me nenin 3 (1.2.5.) vepra penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 (2) të KPP-së bie nën fushëveprimin e amnistisë. Pasi që S. G. e ka kryer këtë vepër penale para datës relevante në nenin 2 (1) të Ligjit për amnisti, ai duhet të lirohet nga ndjekja penale për këtë krim, dhe prandaj Gjykata Supreme e refuzon këtë akuzë kundër S. G., dhe i pandehuri S. G. lirohet nga dënimi me gjobë.

3.14. Përndryshe, pa marrë parasysh ri-cilësimin e veprave penale të Krimeve të luftës në një vepër të vetme nga Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme nuk gjen asnjë arsye për ta prekur dënimin e S. G.. Gjykata e shkallës së parë e ka përmendur veçmas gjendjen e tij të dobët shëndetësore në paragrafin 268 të aktgjykimit të saj, dhe Gjykata ishte në dijeni për rrethanat e tij personale. Në fund, Gjykata pret që sjellja të jetë e mirë gjatë gjykimin, që është edhe çështje e mirësjelljes themelore, dhe nuk është diçka që duhet të shpërblehet me ulje të dënimit.

#### D. R. A.

3.15. Avokati mbrojtës për R. A. pohon se të dy aktgjykimet ishin të bazuar në prova të papranueshme, por nuk jep hollësi të tjera, që e bën të pamundur për Gjykatën Supreme ta përcaktojë këtë pretendim. Prandaj, nuk ka shkelje siç është pretenduar.

3.16. Avokati mbrojtës po ashtu pohon se është i dënuar për dy (2) vepra penale dhe është dënuar me kohëzgjatje të ndryshme të dënimit me burgim në pjesë të ndryshme të aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata Supreme vëren se aktgjykimi është shumë i qartë se dënimi unik i tij ishte caktuar në dymbëdhjetë (12) vjet burgim. Gjykata e Apelit e ka dënuar atë, pas ri-cilësimit të veprave penale si një vepër penale e krimeve të luftës kundër popullsisë civile, me 12 vjet burgim. Dënimi është i qartë dhe nuk ka asnjë të ligjit penal siç pretendohet. Gjykata Supreme nuk vëren asnjë arsye për ta prekur dënimin e të pandehurit.

#### E. S. R.

3.17. Avokati mbrojtës për S. R. parashtron se për ta shpallur dikë fajtor duhet që dashja e të akuzuarit të bazohet në prova dhe fakte të pamohueshme, çdo dyshim lidhur me faktet duhet të interpretohen në favor të të pandehurit, se i pandehuri nuk mund të jetë fajtor për veprim në bashkëkryerje sipas nenit 22 (të KPRSFJ-së) si dhe përgjegjës sipas nenit 26 të ‘LAP’ sepse përgjegjësia sipas nenit 26 e konsumon përgjegjësinë nga neni 22, dhe për ta gjetur bashkëkryerjen nga neni 22 duhet të ketë një plan gojor ose me shkrim për veprën penale. Ky kolegji konsideron se këto pretendime janë moskuptime të ligjit. Së pari, dashja dhe fajësia nuk duhet patjetër të bazohen në fakte të pamohueshme. Më tepër, është detyrë e gjykatës që të përcaktojë cilat fakte janë vërtetuar. Së dyti, nuk ka as tendosje midis neneve 22 dhe 26 të KPRSFJ-së pasi që neni 26 nuk përmendet në dispozitivin e asnjërit aktgjykim. Përveç kësaj, siç është theksuar në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit si përgjigje në këtë parashtrësë, neni 22 nuk përmend kushte për marrëveshje paraprake, me gojë apo me shkrim, për konstatuar ndërmarrjen e bashkuar kriminale.

3.18. Duke marrë parasysh se pretendimet janë dukshëm jo meritore, nuk ka asnjë arsye për arsyetime të mëtutjeshme. Nuk ekziston asnjë shkelej siç pretendohet në kërkesë.

#### F. Përfundimi

3.19. Gjykata Supreme nuk mund të vërtetojë asnjë shkelje të pretenduar në kërkesa.

#### **Kryetar i kolegjit**

---

Timo Vuojolahti

Gjyqtar i EULEX-it

#### **Anëtarë të kolegjit**

#### **Procesmbajtëse**

---

Kerry Kirsten Moyes

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Willem Brouwer

Gjyqtar i EULEX-it

Valdete Daka

Gjyqtare e Gjykatës Supreme